



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.04.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit” (*Komision për dhë dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Fatjon Veizaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla

Mungojnë:

Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Rahman Rraja dhe Flamur Hoxha,.

Të ftuar:

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Kesjana Halili – Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Elona Mistrovica – Drejtoreshë e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Ildir Gjata – Këshilltar i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gerta Ismailaja – Përgjegjës Sektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Ujësjetës

Kanalizimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Flaur Shoshi – Nënkyetar AKUM-it

Anisa Ruseti – Nënkyetare e Bashkisë Tiranë

Elton Kacidhja – Drejtor i UKT-së

Evis Gjebrea – UKT-së

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit”.

Ne jemi komision përgjegjës dhe relator kemi zotin Laert Duraj.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi të ftuar zëvendësministren, zonjën Adela Xhemali, dhe zonjën Kesjana Halili, drejtoreshë në Drejtorinë e Përgjithshme.

Mirë se erdhët!

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi të ftuar zëvendësministren, Enkelejda Muçaj.

Enkelejda Muçaj – Mirë se ju gjeta!

Ju faleminderit!

Arben Pëllumbi – Gjithashtu kemi të ftuar zonjën Gerta Islamaj, zotin Flaur Shoshi, nënkryetar i AKUM-it.

Mirë se erdhët!

Ndërsa nga Bashkia e Tiranës kemi të ftuar nënkryetaren, Anisa Ruseti, drejtorin e Ndërmarrjes Ujës-jellës-Kanalizimeve, Elton Kacidhja, dhe zonjën Evis Gjebrea.

Mirë se erdhët!

Kush nga ju dëshiron të bëjë prezantimin e parë?

Fjala për ju, zonja Zëvendësministre.

Enkelejda Muçaj – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të këtij komisioni,

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kënaqësinë të paraqesë para jush këtë projektakt “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit”, i cili përbëhet nga dy komponentë kryesorë: unaza e presionit të lartë për qytetin në vetvete dhe furnizimi me ujë i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë, pra praktikisht shfrytëzimi i një burimi

të ri për furnizimin me ujë të qytetit. Ky financim arrin në masën 80 milionë euro dhe synon të realizojë furnizimin dhe shpërndarjen me ujë për qytetin e Tiranës për të përmirësuar jetesën për 800 mijë banorë të këtij qyteti, duke siguruar furnizim të sigurt fillimisht dhe të vazhdueshëm me ujë në përputhje me direktivën e ujit të pijshëm nr. 9883/EC të transpozuar tërësisht me VKM-në nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm në qytet”.

Të nderuar, në lidhje me komponentët, për të cilët do të flasim edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera, ne mund të paraqesim që punimet përbëhen nga dy komponentë kryesorë, që i përmendëm në vijim, pra ndërtimi i një unaze furnizimi me ujë me presion të lartë, duke përfshirë zonat që kanë nevojë për këtë shërbim, që do të realizojë furnizimin me ujë 24 orë në ditë në 90% të *target-it*, që janë 800 mijë banorët. Kjo do të reduktojë konsumin e energjisë me eliminimin e pompave të kushtueshme dhe jo efikase të ujit, pra duke adoptuar një teknologji të re, si dhe do të përmirësojë cilësinë e ujit të pijshëm, duke eliminuar sistemin e rezervuarëve të vegjël individualë të ndërtuar mbi çati, një nga problemet shumë të përfolura, të analizuara dhe të diskutuara në lidhje me ndotjen e ujit dhe parametrat e tjerë. Një komponent shumë i rëndësishëm është ai i zhvillimit të burimit të ri natyror të Gurit të Bardhë, që ndodhet 25 kilometra në verilindje të Tiranës.

Investimet përfshijnë ndërtimin e tubacioneve të reja në gjatësinë 42 kilometra dhe rindërtimin e 10 kilometrave tubacione, sektorizimin e zonave të furnizimit të rretheve, përdorimin e sistemit SCADA, sistemi elektronik lidhur me monitorimin e furnizimit me ujë në komponentët e vetë teknikë dhe të cilësisë së ujit, si dhe në instalimin e strukturës së marrjes apo përfitimit të ujit nga burimi i Gurit të Bardhë me një tubacion graviteti të furnizimit me ujë rreth 20 kilometra, një tunel 1,7 kilometra dhe tubacion nga hidrocentrali i Lanabregasit në rezervuarin me ujë në malin e Dajtit me gjatësi 5,3 kilometra.

Të nderuar, në fakt, kjo kontratë ka marrë miratimin dhe është nënshkruar nga palët për vlerën 144,5 milionë euro, nga të cilat Banka Europiane e Investimeve angazhohet për vlerën 80 milionë euro me një vlerë maturimi për 25 vjet, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 5 vjetësh. Sigurisht që ka dhe kushtet e disbursimit, të cilat do të realizohen në momentin më të parë që plotësohen një sërë dokumentacionesh, i cili është parashikuar në mënyrë të veçantë në projekt dhe në kontratën bashkëlidhur këtij akti.

Ky ishte parashtrimi që të mos u marrim më tepër kohë anëtarëve të nderuar.

Nëse Ministria e Financave do të donte të shtonte diçka në këtë fazë, ose Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve me pyetje, unë do mundohem t'u përgjigjem.

Faleminderit për vëmendjen!

Arben Pëllumbi– Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Po zoti Duraj.

Laert Duraj – Përshëndetje të gjithëve!

Pak a shumë informacioni i dhënë nga zëvendësministrja përfshin edhe pjesën kryesore të të dhënave në lidhje me këtë projektligj për të ratifikuar kontratën financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit”.

Në pikëpamjen kohore gjykoj që diskutimi në komisionin tonë të këtij projektligji është moment shumë i përshtatshëm, pasi është në vazhden e dy diskutimeve që kemi bërë kur kemi pasur në fokus ujin dhe ku unë kam qenë relator.

Pasi diskutuam për ERRU-në, kemi bërë gati projektrezolutën për ta kaluar në parlament strategjinë e vitit 2022, dhe analizuam raportin vjetor të ERRU-s, ku krahas gjërave të mira u evidentuan edhe probleme, gjykoj që është momenti dhe qasja e duhur që ky projektligj vjen në komisionin tonë. Bëhet fjalë për një projekt që kushton 144,5 milionë euro dhe, nëpërmjet kësaj kredie dhe angazhimit të fondeve të UKT-së, besoj se do të jetë projekti i duhur për t'i dhënë një zgjidhje definitive problemit të ujit në Tiranë.

Pa diskutim, i ftoj kolegët ta votojnë këtë projektligj, pasi besoj se kjo është qasja e duhur që duhet të kemi për problemet. Një problem madhor dhe strategjik, siç është uji në një qytet me një zhvillim dinamik si Tirana, mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet projekteve madhore, të cilat në këtë rast financohen edhe nga miqtë tanë të BE-së. Fakti që gjithë kjo procedurë e gjatë ka ardhur në tryezën tonë, tregon se janë kaluar hallka dhe filtra shumë të qartë dhe të rreptë kontrolli dhe vlerësimi.

Shpresoj që pas diskutimeve për këtë projektligj ta votojmë siç është paraqitur.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Fillojmë me pyetje dhe diskutime e kolegëve.

Kush dëshiron?

Zoti Zeqaj.

Baftjar Zeqaj – Në këtë material flitet për koston e shpronësimeve, por nuk ka një shifër. A e keni në shifër, apo kjo do të dalë gjatë ecurisë? Cila është sasia aktuale e ujit që merr Tirana dhe cila është sasia e ujit që do të shtohet pas këtij investimi?

Pyetja tjetër është: sa kohë do të vazhdojnë punimet me miratimin e kësaj marrëveshjeje? Kur fillojnë, kur mbarojnë, sa kohë vazhdojnë?

Anisa Ruseti – Shumë faleminderit!

Në fakt, ky është një moment që Bashkia e Tiranës e falënderon Këshillin e Ministrave dhe qeverinë, e cila gjeti një mekanizëm për të mbështetur furnizimin e popullit të Tiranës me ujë 24 orë në ditë.

Në lidhje me pyetjen tuaj për shpronësimet, kjo do të bëhet në një moment të dytë, pasi të ketë mbaruar faza e studimit të fizibilitetit, ku do të kemi një vlerësim definitiv të objekteve, që do të preken nga investimet në terren dhe do të shkojnë me shpronësime, por Bashkia e Tiranës është e angazhuar që e gjithë vlera që do të shkojë për shpronësim të jetë e mbuluar nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

Në lidhje me afatin e punimeve, ne parashikojmë që punimet të përfundojnë brenda vitit 2025, kur të kemi realizuar furnizimin me ujë për më shumë se 800 mijë banorë 24 orë në ditë.

Ndërsa për sa i përket sasisë së ujit që kemi tani, do t'ia kaloi fjalën time kolegut Elton Kacidhja.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Kacidhja.

Elton Kacidhja – Përshëndetje!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Po bëj një plotësim të pjesa e shpronësimeve. Ne jemi përpjekur që të paktën për unazën e presionit, i gjithë tubacioni, ato 42 kilometra, tubacion, 1200-ësh, 1000-ësh apo 900-ësh, se janë me seksione të ndryshme, të kalojnë nëpër rrugët kryesore, pra të mos kemi pengesa në këtë aspekt, pra nuk kemi situata me pronën private, edhe linja e transmetimit nga Guri i Bardhë kalon nëpër zona-shtet, kryesisht janë zona malore, pyje e kullota, që janë pronë e shtetit. Me konstatimet dhe nga vlerësimi paraprak që kemi bërë nuk na rezulton të ketë prona private në segmentin ku kalon.

Sa i takon furnizimit me ujë, qyteti i Tiranës furnizohet me 18 orë ujë, si mesatare e të gjithë qytetit, prandaj kemi ardhur këtu sot që të diskutojmë këtë financim, për këtë projekt madhor, në mënyrë që me zbatimin e këtij projekti, shtimit të furnizimit nga Guri i Bardhë, që

plotëson bilancin e ujit që kërkon Tirana, me 3600 litra ujë në sekondë për qytetin, ne të arrijmë në nivelin e furnizimit 24 në 24.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Kacidhja!

Ndokush tjetër dëshiron të flasë?

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Së pari, dua të theksoj se kolegët e opozitës dhe opozitës nuk janë kundër përmirësimit të furnizimit me ujë jo vetëm të Tiranës, por të çdo qyteti në Shqipëri. Problemet dhe shqetësimet që kemi kanë lidhje me rritjen e borxhit publik, pa dyshim që ky 80-milionësh ndikon në rritjen e borxhit publik, kemi problem garantimin e eficiencës së këtij investimi. Në këto kushte, gjë që nuk e gjej në relacion, do të isha shumë i interesuar për të pasur informacion shtesë për afatin e disbursimit, se pyetja e kolegut të nderuar ishte kur mbarojnë punimet.

Çështja e disbursimi nuk rezulton në asnjë pikë të relacionit dhe normalisht as te projektakti. Besoj se ky është një defekt i atyre që kanë përgatitur aktin. Afati i disbursimit është gjëja kryesore.

E dyta, këto fonde janë në kuadër të marrëveshjes kuadër e vitit 1996 mes BEI-së dhe qeverisë shqiptare, parashikohen të jenë së bashku.

U tha këtu nga relatori që vlera e përgjithshme është 144,5 milionë euro. Unë, përveç pjesës së TVSH-së ,që është e shpjeguar qartë, do të doja të dija: sa nga këto fonde (pjesa që i përket shtetit), do të mbulohen me të ardhurat e vetë UKT-së dhe sa nga buxheti i shtetit? Dua të sqaroj këtë gjë dhe ju duhet ta keni parasysh në momentin kur do ta na sqaroni më vonë: ka pasur dy rritje çmimi uji për qytetarët e Tiranës në 2016-n dhe 2020-n. Këto rritje çmimi kanë qenë të argumentuara pikërisht me faktin për t'i garantuar dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe kohëzgjatjen e furnizimit me ujë për qytetarët e Tiranës.

Në atë kohë u dhanë disa *deadline* dhe nëse nuk gaboj, *deadline*-i për furnizimin 24 orë me ujë të mbi 90% të banorëve ka qenë viti 2021, sot jem në mars 2022. Prandaj këtu kërkohet që ju ta na sqaroni se sa do të mbulohet nga UKT-ja dhe sa nga buxheti i shtetit për pjesën publike të kontributit, si dhe kur do të kemi një afat të qartë të furnizimit të plotë të qytetit të Tiranës me ujë 24 orë?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi– Faleminderit, zoti Bushati!

Para se të përgjigjet dikush, do të doja të bëja një korigjim. E thashë dhe më parë në fjalën time, që jemi komision përgjegjës, por në fakt jemi komision për dhënie mendimi, sepse komisioni përgjegjës është Komisioni për Ekonominë dhe Financat, ishte një lapsus imi qëparë.

Anisa Ruseti – Sikundër është paraqitur edhe në projektaktin që do të miratoni sot, vlera e aktit është 144,5 milionë euro në total, nga të cilat 80 milionë euro po merren hua nga BEI dhe 64,5 milionë euro janë fonde të UKT-së dhe të tjera dhe këtu kam parasysh të gjitha arkëtimet apo fondi që do të vërë në dispozicion UKT-ja, ose banka të tjera ndërkombëtare, që mund t'i bashkëngjiten këtij investimi.

Në lidhje me komentin tuaj për rritjen e çmimit të ujit, kemi pasur dy rritje të çmimit të ujit një në vitin 2011 dhe një në vitin 2017, të cilat janë bërë efektive në 2018-n, që janë përkthyer në investime. Sot që flasim 65% e popullsisë merr ujë 24 orë, por për shkaqe teknike kjo nënkupton që uji shkon vetëm deri në katin e parë, ose në depozitat që kanë pallatet në zonat e tyre.

Ne po tentojmë që me këtë projekt, i cili është parashikuar edhe në masterplanin e furnizimit me ujë bërë në vitin 2019 me BERZH-in, qytetarët e Tiranë ta kenë ujin 24 orë, qoftë edhe në katet e larta të pallateve të tyre. Ky është një diskutim që ne e kemi parashikuar me ministrinë përgjegjëse si bashkëfinancim të huasë dhe fondeve të UKT-së.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Zonja Ruseti, ajo që doja unë janë dy të dhëna të sakta.

Afati i disbursimit, i cili do të jetë afati i disbursimit, për të cilin nuk mora përgjigje dhe, e dyta, jam i sigurt që është përmirësuar shërbimi i furnizimit me ujë, por përsëri ju thoni se 65% e popullsisë në katet e para. Objektivi juaj për përmirësimin e furnizimit me ujë është eliminimi total i atyre që i quajmë depozita, nga përdorimi i të cilave është prekur secili prej nesh në një mënyrë apo tjetër.

Për këtë do të doja një afat se kur do të arrihet që Tirana të ketë 24 orë ujë dhe të mos ketë fare nevojë për depozita, se për këtë po diskutojmë, pra projektin e përgjithshëm prej 144 milionë eurosh.

Anisa Ruseti – Ju kërkoj ndjesë që nuk iu përgjigja pyetjes suaj në fillim! Maturimi është 25 vjet, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 5 vjetësh, ndërkohë që pagesat do të jenë me 20 këste të ndara në 4 vjet dhe kjo do të shkojë në vijim të ecurisë së punimeve që do të

bëhen në terren. Pra, çdo 4 vjet do të paguhet nga një këst dhe do të fillojë patjetër me miratimin edhe të PIU-t, që është njësia e zbatimit të projektit, ku do të kihet parasysh e gjithë ecuria e projektit që ka të bëjë me prokurimin, me zbatimin dhe me kapacitetin operativ në përgatitjen e projektit, e kështu me radhë. Pas çdo miratimi të një faze të projektit do të vijohet me këstin në fazën e dytë.

Ndërkohë kolegu im, Elton Kacidhja, ka diçka për të shtuar në lidhje me afatin se kur Tirana do të ketë 24 orë furnizim me ujë.

Elton Kacidhja – Sikurse e përmendi edhe nënkryetarja, do të varet shumë nga ecuria e punimeve. Ne e dimë shumë mirë që me këtë projekt strategjik Tirana do t'i nënshtrohet një kantieri gjigand, ku i gjithë projekti do të ndahet në disa lote, ku nëntoka mund të ketë gjithmonë gjëra të paparashikuara dhe situata ku mund të ketë shtyrje minimaliste të projektit. Ne synojmë që mbarimi i projektit të jetë në kohën e disbursimit final të të gjithë fondit. Domethënë, nëse flasim për 20 këste nga 4 milionë euro të përfshira për t'u disbursua në 4 vjet, në fund të disbursimit të këstit të fundit, ne synojmë të jeni në finalen e mbylljes së projektit. Kjo do të thotë që Tirana të ketë implementuar linjën e transmetimit të Gurit të Bardhë, unazën e presionit dhe minizonat. Këtë projekt po e detajojmë tani, ku Tirana do të ndahet në 54 minizona. Ky do të jetë momenti kur Tirana nuk do të ketë më nevojë për depozitat që kemi mbi pallate apo nënpallate, por do të ketë zona të ndara me presione të caktuara, sipas nivelit të ndërtesave, që do të thotë se atje ku kemi ndërtesa të ulëta, do të kemi presione më të ulëta dhe aty ku kemi ndërtesa të lartas, si qendra e Tiranës, nëpërmjet minizonave, do të ketë edhe presione më të larta, për të mbuluar edhe katet më të larta të ndërtesave në qytet.

Nëse ka ndonjë pyetje teknike apo sqaruese, më thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qendra do të ketë një presion ndryshe nga pjesa tjetër.

Arben Pëllumbi – E mbani atë shprehjen e vjetër popullore: “Leku e hedh ujin për pjetë”? Kështu që, mos u shqetëso kot se me kaç lekë shkon ku të duash!

Zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Në fakt, më duket pak absurde që ndërmarrja e UKT-së të marrë përsëri kredi, sepse ne ende nuk e dimë sa është numri i kredive që ka marrë UKT-ja dhe që ka në vazhdimësi, duke pasur në konsideratë që ajo ka qenë me Kooperacionin Italian. Sa është numri dhe vlera e kredive që ka deri sot?

Së, dyti, duke marrë shkas edhe nga kolegët, para 2-3 vjetësh mbaroi rrjeti i ri i marrjes së ujit nga baseni i Bovillës, zgjerimi i impiantit dhe u tha që do të marrin fund depozitat, pra nuk do të ketë më depozita uji. Ndërkohë sot thuhet që vetëm katet e para marrin ujë 24 orë. Pak ditë më parë ERRU-ja solli buletin, ku thuhej se Tirana merr pothuaj 24 orë furnizim me ujë. A nuk është kjo një kontradiktë?

Është absurde që të merret një kredi për një qytet, i cili futet në ato qytete që furnizohen më shumë me ujë? Pra, nëse kemi 2-3 qytete që furnizohen 24 orë me ujë, po e marrim të mirëqenë sikur kjo nuk ka 24 orë ujë, si mund të merret një kredi 80 milionë euro, nga të cilat 64 milionë do të paguhet nga UKT-ja, pa harruar edhe pjesën e TVSH-së? Kontrata nuk është vetëm 144 milionë euro, se keni edhe 28,9 milionë TVSH, që do të paguhet nga buxheti i shtetit. Me ç'të drejtë i jepet një mbështetje financiare nga buxheti i shtetit një ujësjellësi, që, krahasuar me 15 vjet më parë, e ka 4-fishuar çmimin e ujit të pijshëm, ndërkohë që ka marrë edhe kredi pafund? Nëse u referohemi bashkive të qyteteve të tjera, të cilat furnizohen vetëm 30 minuta me ujë, a nuk do të ishte e udhës që këto para të shkonin për kredi për një qytet tjetër, që është në situatë mizerabël dhe të mos shkojnë për Tiranën? Kur janë bërë disa investime të tjera më parë është thënë se do t'u jepej fund depozitave.

Kur merret një kredi duhet të shihet edhe performanca, por ajo që ka ndodhur tek ujësjellësi i Tiranës, në dallim nga ujësjellës të tjerë, shohim që, kudo që bëhet një modernizim apo furnizim 24 orë apo automatizim, kemi ulje të numrit të punonjësve për njëmijë lidhje. E kundërta ndodh me Bashkinë e Tiranës, apo më saktë, me ujësjellësin e Tiranës dhe me disa ujësjellës të tjerë, të cilëve u rritet standardi dhe me të njëjtin rritëm progresiv u rritet edhe numri i punonjësve, që faktikisht duhet të ndodhë e kundërta. Jam i sigurt që kjo nuk bëhet për shkak të shërbimit ndaj qytetarëve, por nga një pjesë e konsiderueshme e tyre për të luajtur rolin e patronazhistit.

Unë, si pjesë e këtij komisioni, do të isha mëse i angazhuar, nëse do të kisha pasur disa nga këto indikatorë se sa është numri i kredive, vlera e kredisë, numri i punonjësve, sa janë humbjet teknike të ndërmarrjes aktualisht.

Së dyti, nuk e di sa është debia e ujësjellës kanalizimeve, abonentëve familjarë apo bizneseve. Ndërkohë, nuk e di sa mund të jetë debia e ujësjellësit ndaj të tretëve, edhe ndaj qeverisë. Pra, sa është borxhi i marrë nga qeveria për kreditë, për interesat, për TVSH-në dhe për shumë të tjera. Kështu që në këtë këndvështrim, unë e quaj jo normale, edhe në raport me

ujësjellësit e tjerë që vuajnë për furnizimin me ujë, por edhe jo normale për një ujësjellës që pretendon se furnizohet 24 orë dhe të marrë një kredi, jo 144, por një financim me vlerë 180 milionë, ku vetëm 80 prej tyre janë kredi. E gjithë kjo shumë nuk do të shkojë vetëm në kurrizin e ujësjellësve të Tiranës, por do të paguaj çdo qytetar shqiptar, që nga Vermoshi deri në Konispol. Këto ishin shqetësimet e mia dhe do të doja të dija prononcimin tuaj lidhur me vërejtjet apo paqartësitë e mia.

Arben Pëllumbi- Faleminderit, zoti Mziu!

Kush e do fjalën?

Zoti Kacidhja, fjala për ju.

Elton Kacidhja- Faleminderit për pyetjen, zoti deputet!

Sigurisht, të menaxhosh një ndërmarrje ujësjellësi nuk është e lehtë dhe ju e dini shumë mirë, por di t'ju them që mënyra sesi ne e konceptojmë një plan strategjik dhe mënyra sesi ne i shtrijmë investimet në kohë bëhen duke u bazuar në një masterplan, që ka një logjikë financiare në rritjen e performancës në aspektin menaxherial, rritje të performancës në aspektin ekonomik, si dhe në uljen e humbjeve. Kjo nuk bëhet me shkop magjik, por bëhet me projekte, me investime dhe me angazhim për t'i çuar këto projekte deri në fund dhe jo për t'i lënë përgjysmë.

Unë di t'ju them që, po e nis nga të dhënat e fundit,, ne ujësjellësin e gjetëm me 72% humbje dhe sot e kemi çuar në 61,4%. A është ky maksimumi?! Jo. a ka punë për të bërë?! Po, sa të duash.

Ujësjellësin ne e gjetëm e nivelin 68% arkëtim korrent dhe sot e kemi 85,8% arkëtim korrent. Sigurisht që ka shumë për të bërë dhe kjo është një punë e vazhdueshme, qoftë për formalizmin e atyre lidhjeve që janë tashmë për bizneset apo familjarët, qoftë për formalizmin e objekteve që mund të ketë nëpër titanë, ku mund të ketë tek-tuk edhe pa kontratë, qoftë për eliminimin e vjedhjeve. Investime të tëra të bëra ndër vite, flas 15-20 vjet investime, të cilat nuk janë bërë siç duhen dhe nuk janë bërë brenda një kuadri kujdesi qoftë në zbatim, qoftë në ruajtjen e atij investimi, që do të thotë lidhje të dyfishta, të trefishta, që ne i kemi parë, i kemi prerë dhe po punojmë çdo ditë, prandaj kemi edhe rritje të arkëtimit dhe ulje të debisë, debi që pjesa e madhe është e 10 apo 15 vjetëve më parë. Këtë debi po ta marrësh dhe ta analizosh, ne mund të bëjmë edhe një mbledhje në komision, në mënyrë që t'ju sjell me detaje, janë kontrata dublikate, të hapura, me ndryshim emri, me ndryshim germash, të cilat kanë krijuar këtë lloj

debie në ujësjellës, që nuk ka Perëndi që e zgjidh, jo më komision, gjykatë apo organ tjetër ligjor. Sigurisht që këto janë detaje që ne i kemi në trajtim dhe po merremi çdo ditë me to.

Sa i përket numrit të punonjësve, ne nuk e rrisim e numrin e punonjësve se kemi dëshirë të rrisim, me 100 veta apo 50 veta, por bëhet një analizë serioze për një sh.a., apo për një korporatë, të numrit punonjësve. Për shembull, marrim rastin e faturuesve, si bëhet analiza, sa kontrata të reja hapen në vit, kur është bërë rritja e fundit të numrit të faturuesve. Pra, ka një përlllogaritje që bëhet. Nëse ne rritemi me 8000 apo 10 000 kontrata në vit, sigurisht që mbulimi i zonës duhet të ndryshojë, që do të thotë se duhet të ndryshojë edhe numri i punonjësve. Rritja e punonjësve nuk bëhet në ajër, por është e detajuar dhe e mbështetur në argumente. Këtu flasim për një qytet që po rritet çdo ditë, ose më saktë çdo vit me 50 000 banorë të rinj. Ju thoni që të shkurtojmë numrin e punonjësve në një qytet që po rritet çdo ditë?! Jo, kjo nuk ndodh. Rishikimi i numrit të punonjësve, sipas detyrave funksionale, do të ndodhë kur të mbarojnë projektet strategjike, që do të thotë kur të futet në punë sistemi skada, i cili bën menaxhimin e qytetit. Vetëm atëherë mund ta rishikojmë numrin e punonjësve për ato funksione që nuk bëhen nga njerëzit, por nga sistemi. Çdo gjë ka një arsytim, një logjikë dhe një analizë korrekte që bëhet.

Diskutuat për rritjen e çmimit, por dua t'ju them se të vetmen rritje çmimit që ne kemi bërë është në vitin 2017, i cili është vënë në funksion dhe ka marrë fuqi ligjore në vitin 2018, me 20 lekë, ndërsa ai më parë është bërë në vitin 2011. Pra, ka një hapësirë shumë të madhe në kohë. Normalisht, për një shoqëri si ujësjellësi, duhet çdo 3-4 vjet të bësh një analizë dhe të shohësh nëse je në kushte për ta ndryshuar çmimin apo jo. Flasim për një kompani serioze dhe jo për sh.sa. që nuk dinë si dhe nga menaxhohen. A është i mjaftueshëm çmimi aktual?! Kjo është për t'u diskutuar dhe për t'u parë, gjithmonë duke pasur parasysht edhe performancën e organizatës, të shoqërisë, si për shembull, sa rritet, sa e ulë debinë nder vite, si ulet debia e mbledhur në raport me gjenerimin vjetor që bën e të tjerë.

Lidhur me kreditë, ne kemi një kredi të marrë përpara pak vitesh nga BERZH-i, të cilën e morëm për shtesën e parë të impiantit, që iu shtua sasisë që ishte, pra, nga 1800 e çuam në 2400, u shtua me 600 litra ujë në sekondë. Ajo shtesë kredie u mor për këtë shtesë impianti dhe një pjesë u mor për investimet e tjera kapitale të rrjetit, pra për zonat e caktuara të qytetit që janë bërë me rrjet të ri. Kjo kredi ka një fazë shlyerjeje që është e shtrirë në 12 vjet dhe, në momentin që flasim, nuk është rëndesë e madhe për buxhetin aktual të UKT-së.

Kredia tjetër është kredia italiane, tek e cila janë 4 brenda këtij komponenti. Totali është 60,3 milionë euro. Janë disa këste të pashlyera, por që ne jemi duke paguar një pjesë të asaj kredie, pasi një pjesë paguhet nga ministria. Nëse ju nevojitet një raport më i detajuar për këtë, ne mund t'ju sjellim të detajuar me këste, me data dhe afate.

Xhelal Mziu- Së pari, unë nuk mora përgjigje për numrin e punonjësve për një mijë lidhje, sepse e bëtë më shumë teori, por mbaj mend që në një raport të vitit 2007 kishte 942 vetë dhe 185 mijë kontrata. A mund të më thoni ju se cili është raporti sot?

Së dyti, lidhur me pyetjen e situatës debitore që kanë sot klientët ndaj UKT-së, si dhe situatën debitore që ka UKT-ja ndaj institucioneve shtetërore, si për shembull, ndaj sigurimeve shoqërore dhe institucioneve të tjera, por edhe kredi, të cilat janë marrë nga UKT-ja dhe paguhen nga qeveria shqiptare. Pra, në vend që këto kredi të paguheshin nga ujësjellësi, qytetarët shqiptarë marrin riskun e kësaj pagese. Pra, dua gjëra konkrete.

Në lidhje me pjesën e humbjeve që thoni se nga 70% janë ulur në 61%, ne nuk jemi aq larg standardeve të Bashkimit European, aq më tepër që kjo ndërmarrje ka pasur fokusin dhe mbështetjen jo vetëm të qeverisë, por edhe të organizmave ndërkombëtarë, duke e mbështetur me kredi të herëpashershme. A ju duket shifër e mirë 61%, krahasuar me 25% sa është mesatarja e vendeve të Bashkimit European?

Arben Pëllumbi – Në vazhdim të pyetjes që bëri zoti Mziu, që të mos përgjigjeni disa herë, kam edhe unë nja dy gjëra në lidhje me pjesën e humbjeve, sepse ju thatë se e keni ulur nga 72% në 61%...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më shumë për kuriozitet të kolegëve, por edhe për ta ditur: çfarë përbëjnë 61% të humbjeve, ku është pjesa më e madhe e humbjeve që humbet në cilësinë e rrjetit që kemi, nga lidhjet e paligjshme, pra ku ndodh kjo? Duke kuptuar këtë gjë të kuptojmë realitetin, ku tentojmë ta çojmë në fund të këtij projekti nivelin e humbjeve?

Në përgjithësi, dua të di edhe faktin se një ndërmarrje e mirë ujësjellësi, moderne në një vend të Bashkimit European sa e ka nivelin teknik të humbjeve? Domethënë, cili konsiderohet një nivel poshtë të cilit nuk zbritet çfarëdo që të bësh ti?

Elton Kacidhja – Faleminderit për pyetjen, zoti kryetar!

Të flasësh për humbjet, nuk është e lehtë, pasi sot ndërmarrje shumë serioze në Europë, dhe këtu flasim për ndërmarrje si ujësjellësi i Pragës, fjala që bie, për të ulur humbjen me 4 pikë

kanë bërë një strategji 6-vjeçare. Sigurisht, ato kanë arritur një nivel shumë të lartë në raport me ne, por flasim për detaje, të cilat kërkojnë kohë, kërkojnë investime dhe mund që të arrish të ulësh humbjet me kaq pikë. Kur ujësjellësi kaloi në menaxhimin e Bashkisë në Tiranë dhe në drejtimin e kryetarit Erion Veliaj u mor me 72% humbje dhe sot jemi në 61,4% humbje, pra është ulur me disa pikë. Standardi europian teknik për humbjet është në nivelin 20%-25%, që justifikohet humbja, dhe më pas kuptohet që ndërmarrjet, duke bërë një analizë financiare dhe menaxheriale, vendosin nëse do të investojnë më shumë para për të ulur humbjet apo këto para nuk e justifikojnë vazhdimin e uljes së humbjeve. Humbjet janë të karakterit teknik dhe të karakterit komercial. Për humbje teknike të rrjetit flasim, duke filluar që nga linjat e nivelit të parë, të nivelit të dytë dhe të nivelit të tretë deri në nivel kapilar; dhe komercialet janë vjedhjet, humbjet e rrjetit terciar, keqmatjet nga sahatet, pra ka një sërë detajesh teknike që përcaktojnë humbjet komerciale. Ne i kemi të dyja, por për ta ulur këtë nivel në nivelin që foli zotëria, kërkon këto investime që ne flasim. Pra, është bërë një punë e jashtëzakonshme, patjetër janë bërë investime dhe prandaj janë reduktuar uljet me kaq pikë, por që ta ulim akoma më shumë duhen këto investime. Pra, nëse ne e mbyllim këtë projekt brenda afatit që kemi thënë dhe patjetër që do ta mbyllim, humbjet do të ulen me një nivel standard që e kanë qoftë vendet e Europës, qoftë vendet e rajonit me të cilët, ne mund të krahasohemi. Pra, janë investime që i ulin humbjet në minimum dhe dalim në ato standarde teknike humbjeje që i ka gjithë Europa apo Ballkani.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unaza e presionit sot sistemin e ujit të Tiranës nga një rrjet i hapur e bën një rrjet të mbyllur, pra e fut në një unazë presioni. Implementimi i 54 mini zonave, që qyteti të ndahet në 54 mini zona presioni, do të bëjë që humbjet të reduktohen në nivelet e pranueshme të një standardi europian. Patjetër, që po. Mbyllen me cikle?! Patjetër që mbyllen edhe me cikle dhe këtu flasin bazuar në projekte, në shembuj konkretë dhe në atë që unë diskutova. Prandaj i mëshojmë fort këtij investimi, prandaj i mëshojmë fort kësaj kredie, që duhet të vijojë, duhet të implementohet në mënyrë që humbjet të shkojnë në nivele optimale.

Detyrimet që në i kemi palëve të treta dhe këtu flas për OSHEE-në, si çdo detyrim tjetër që ne gjetëm në ujësjellës e menaxhuam dhe po menaxhojmë edhe detyrimet edhe ndaj Operatorit të Shpërndarjes, ku nuk gjenerohet më në debi, por paguhen kështu e rregullta mujore për konsumin e energjisë që kemi, dhe paguhet edhe diferenca e asaj që ka qenë borxhi i

mbartur i OSHEE-së, që aktualisht është në nivelin e 344 milionë lekë, por është futur në një rregullsi dhe paguhet rregullisht nga UKT-ja, pra nuk më gjenerohet më debi.

Për abonentët debitorë ne kemi bërë një analizë, të cilën po e përfundojmë. Për sa i përket asaj debie, që konsiderohet e shëndoshë, mund të mblidhet dhe, asaj debie që konsiderohet jo e shëndetshme, ku gjenden kontratat që unë përmenda pak më parë, janë të mbartura 10, 15 apo 20 vjet më parë. Ato janë kontrata dublikate, me ndryshime emri, nga “E-ja” e bën “Ç” dhe hap kontratë tjetër për të fshehur debinë e të tjera, të cilat ne jemi duke i parë dhe vlerësuar për të gjetur mënyrën e trajtimit të tyre. Pra, ne do të gjejmë mënyrën sesi do të trajtohet kjo lloj debie që është jo e shëndetshme në raport me atë që është mbledhshme për të cilën ne po punojmë çdo ditë. Ne e kemi rritur arkëtimin e debisë me 8-fish në raport me atë çfarë është mbledhur më parë.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit!

Zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit për shpjegimet që dhatë!

Në fakt, dua të pyes, sepse jam pak i paqartë nga ajo që dëgjova deri tani, vlera 144,5 milionë euro vjen si rrjedhojë e një projekti final, sepse thamë kemi dy komponentë: linja e Gurit të Bardhë dhe unaza e presionit e qytetit, pra nëse kemi projekte finale do të doja vlerat respektive sa është njëra dhe sa është tjetra?

Së dyti, qoftë në relacion, por qoftë edhe në diskutimin që po bëjmë sot, nuk dëgjoj që qyteti i Tiranës do të furnizohet me uji të pijshëm, por themi qyteti do të furnizohet me uji. Në fakt deri më sot banorët e Tiranës nuk janë furnizuar me uji të pijshëm, pra me këtë investim, a do të kemi në rubinet uji të pijshëm apo do të kemi uji sanitar?

Më duhet të korrigjoj në mos gaboj nënkryetaren, e cila tha që diferencën prej 64,5 milionë euro do ta financojë pjesërisht bashkia dhe pjesërisht me donacione. Në fakt, në relacion nuk thuhet kështu. Në relacion thuhet: 28,9 milionë euro që është TVSH-ja do të financohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër është në programin buxhetor afatmesëm të Ministrisë së Infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizime, pra nuk është financim i bashkisë. Besoj se është gabim apo keqcitim, pra i gjithë financimi do të jetë me buxhet ose e kundërta, duhet të korrigjojmë këtu dhe të themi: po, pjesë e financimit do të jetë edhe Bashkia e Tiranës në vlerën kaq. Pra, duhet të korrigjohet në projektligj, besoj unë.

Këto kisha unë lidhur me... Nuk është se kam rezerva për mënyrën se si duhet të zhvillohet Tirana, edhe pse këtu thuhet që ky investim i referohet Strategjisë 2030.

E preku pak drejtori, por unë do të dëshiroja që në këtë komision të kishim një plan të qartë për mënyrën se si do të zhvillohet Tirana, me shifra konkrete, qoftë edhe për këto miniprojektet, në mënyrë që të kemi një panoramë të qartë se sa do të jetë vlera finale e investimit që Tirana të ketë ujë të pijshëm 24 orë?

Unë nuk besoj se kjo vlerë do të jetë finale dhe qeveria, qoftë nëpërmjet marrjes së kredisë, qoftë nëpërmjet financimit të saj, e ezauron problemin e furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë në Tiranë.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Gështenja!

Cili do të përgjigjet? Zonja Ruseti?

Anisa Ruseti – Shumë faleminderit, për pyetjen!

Po e nis nga e dyta, e cila ka të bëjë me ujin e pijshëm. Ajo që UKT-ja dhe Bashkia Tiranë deklarojnë është, patjetër, uji i pijshëm, i cili del nga burimi, kalon të gjitha proceset për t'u bërë ujë i pijshëm dhe shkon deri te nyjet furnizuese të pallateve.

Ajo që ne nuk kemi garantuar dot, prandaj është edhe qëllim i këtij investimi strategjik që po bën Bashkia Tiranë, patjetër me mbështetjen e qeverisë, është pikërisht që ne të sigurohemi që tashmë, me gjithë investimin që do të bëhet në 42 kilometra tubacione të reja dhe 10 kilometra strukturim të atyre aktuale, të garantojmë se uji i pijshëm jo vetëm garantohet në burim, por të shkojë deri te familjet dhe tek abonentët individualë.

Kjo ishte në lidhje me pyetjen e dytë.

Në lidhje me pyetjen e parë, se si ne kemi shkuar te vlera 80 milionë euro, ju bëj me dije se 60 milionë euro shkon për *ring*-un (për unazën), 20 milionë euro do të shkojnë për zhvillimin e burimit të ri natyror që është Guri i Bardhë, dhe pjesa tjetër do të shkojë kryesisht për 54 minizona, të cilat do të jenë në të gjithë Tiranën, që kolegët e mi i kanë shpjeguar edhe më përpara.

Kjo është pak a shumë se si ne mendojmë që do të shkojë disbursimi i huas që do të marrim nga Banka Europiane e Investimeve.

Gjithsesi, në momentin që po flasim, po hartohet edhe studimi i fizibilitetit me një grant të *Swiss Fund*-it, i cili do të shkojë deri në detajimin e të gjitha proceseve dhe hallkave që do të duhet të marrë zhvillimi dhe zbatimi i këtij projekti.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja Ruseti!

Ka plotësime nga...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vazhdoni ju, zoti Gështenja? Fjalën e ka zoti Gështenja për një koment.

Lefter Gështenja – Jam i paqartë ose unë e kuptova keq: 60 milionë euro do të jetë unaza e presionit, 20 milionë euro do të jetë linja kryesore...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anisa Ruseti – Guri i Bardhë.

Lefter Gështenja – Guri i Bardhë, linja kryesore. Ndërsa pjesa tjetër, 64 milionë euro do të jenë 54 minizonat?

Anisa Ruseti *(pa mikrofon)* – Po, por ndërkohë bashkë me minizonat do të jenë procese apo projekte të tjera, të cilat...

Fadil Nasufi – Ju lutem, me mikrofon!

Lefter Gështenja – Për këto kanë përfunduar projektet, se për këtë nuk mora përgjigje? Në cilën fazë janë projektet për secilin rast? Cila është situata? Janë projekte finale, fizibilitet, projekt-ide?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Po, zonja Ruseti.

Anisa Ruseti – Projektet për Gurin e Bardhë dhe për ringun kanë përfunduar, ndërsa projektet për 54 minizonat janë duke u zhvilluar tani.

Sikundër jua thashë edhe në fillim, është një proces në dinamikë e sipër, ndaj ne presim që me përfundimin e të gjitha këtyre proceseve të mund të vijmë në idenë finale se sa do të shkojë e gjithë vlera e investimit, sepse ky është patjetër një parashikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Kush tjetër nga kolegët e do fjalën për pyetje?

Po, zoti Veizaj.

Fatjon Veizaj – Zoti Kacidhja, më parë, pyes vetëm për një sqarim, teksa foli për analizën e çmimeve, për rritjen e tyre, dhe për analizën që duhet të bëjë një ndërmarrje serioze, në mos gabohem, përmendi terminologjinë: “nga ndërmarrje që nuk di si dhe nga kush menaxhohen”. Kujt u referohej? Këtë pyetje desha të bëja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Mbylleni mikrofonin. Kush do të përgjigjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Kacidhja.

Elton Kacidhja – Më vjen mirë që ju ngeli mendja tek ajo që unë thashë për ndërmarrjet që nuk dinë të menaxhohen.

Ia përmenda edhe deputetit të mëparshëm, që flas këtu në lidhje me menaxhimin që u është bërë ndërmarrjeve të ujësjellësit ndër vite.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për atë lloj plani flas. Në qoftë se doni më shumë sqarime, po, ju jap.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse më lejoni t'i jap një përgjigje deputetit tjetër, për sa i përket shumës totale të investimit, për këta tre komponentë kjo është shuma totale e investimit.

Ka elemente të tjera që do të plotësojnë të gjithë investimin, siç është sistemi SCADA, që nuk përfshihet në shumën totale, pra jo te këta tre komponentë që përmendëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon): Në relacion është përfshirë.

Elton Kacidhja – Jo, jo...

Atëherë, investimi qoftë në hartimin e projektit, qoftë në implementimin e sistemit SCADA, nuk është i përfshirë në kredinë për të cilën flasim. Në këtë kredi kemi dy komponentë, Gurin e Bardhë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është thënë, se janë projekte plotësuese në vijimësi, pra është thënë brenda gjithë së madhes, që janë minizonat, është edhe SCADA, por në këtë kredi përfshihen vetëm Guri i Bardhë (pra linja e transmetimit të Gurit të Bardhë), burimi ujqor që sjellim dhe ring-u, unaza e presionit. Minizonat janë diferenca e shumës dhe SCADA është jashtë këtij totali, pra është një shumë më vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Zoti Gështenja, keni një ndërhyrje?

Dakord.

Lefter Gështenja – Drejtor, në relacionin e paraqitur në këtë komision thuhet: “Projekti përbëhet nga realizimi i punimeve për ndërtimin e tubacioneve të reja, rreth 42 kilometra, rindërtimi afërsisht 10 kilometra tubacion, sektorizimi i zonave të furnizimit të rretheve, duke përfshirë SCADA-n, rezervuarët e ujit, valvulat e reduktimit të presionit, njësoret dhe pajisje të tjera të ngjashme”. Pra, është e përfshirë në këtë kredi.

Gjithsesi, po keni ndonjë projekt tjetër për SCADA tjetër, na thoni.

Faleminderit!

Elton Kacidhja – Për ta saktësuar, edhe një herë, po flasim për 80-milioneuroshin e kredisë që po merret dhe në këtë shumë përfshihen vetëm dy elemente, linja e Gurit të Bardhë dhe unaza e presionit.

Brenda unazës së presionit, te nyjet që janë parashikuar, që janë rreth 17-18 të tilla, ka edhe elemente që lidhen qoftë me minizonat, qoftë me SCADA-n, që janë, le të themi, matësit e presionit, që lidhen më pas me SCADA-n. Pra, duhet të vendosen matësit paraprakisht që pastaj implementimi i SCADA-s, fshirja e rrjetit dhe ndërtimi i dispeçerisë të jenë në funksion të këtij ringu. Prandaj është përmendur SCADA aty, jo se financohet kjo e fundit. Financohen vetëm dy komponentët që unë përmenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – A ka pyetje ose komente të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, i falënderoj të gjithë përfaqësuesit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A do të votojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj një herë me këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëj unë koment.

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Një sekondë, të lutem!

Unë besoj që pyetjet që bënë kolegët deputetë dhe sqarimet që dhanë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, ata të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë dhe ata të ujësjellës-kanalizimeve qenë shteruese, dhanë informacion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, pra!

...dhanë edhe sqarime përtej kuadrit të marrëveshjes, qoftë në aspektin teknik, qoftë për mënyrën se si do të realizohet investimi dhe pritshmëritë e tij.

Besoj që relatori, me vërejtjet teknike që u bënë, do t'i reflektojë, sepse ne jemi komision për dhënie mendimi, dhe nesër të kryejmë procesin e votimit.

Helidon Bushati – Pse nesër, jo sot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Nesër të bëhet procesi i votimit, për arsye se duhet të reflektohet mbi këto ndërhyrje që u bënë sot.

(Ilaritet në sallë)

Atëherë, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon): Si mbyllet?

Fadil Nasufi – Nesër, pra, votimi!

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA